

(Buxh.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE
DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 203 Prot.

Tiranë, më 24.2. 2026

Lënda: Dërgohet Raporti i Monitorimit për zbatimin e buxhetit për vitin 2025.

MINISTRISË SË FINANCAVE
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", bashkëlidhur ju dërgojmë raportin narrativ dhe anekset e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2025 për Ministrinë e Mjedisit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Ledina Beqiraj Agalliu



RAPORTI I MONITORIMIT TË BUXHETIT

JANAR - DHJETOR 2025

MINISTRIA E MJEDISIT

1. PËRMBAJTJA

- Hyrje
- Informacion buxhetor i agreguar
- Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti
- Performanca e buxhetit në nivelin e programit
 - Performanca financiare e programit buxhetor
 - Performanca jo- financiare e programit buxhetor
 - Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor
- Projektet kapitale
- Ndryshimet në buxhetPërfundime

2. Hyrje

Në zbatim të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, paraqesim në mënyrë të përmbledhur procesin e monitorimit të realizimit të fondeve buxhetore të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2025 si më poshtë vijon:

Programet buxhetore të Ministrisë, në përmbushje të politikave të tyre, kanë kryer të gjitha shpenzimet e nevojshme në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”.

Me Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 25.09.2025 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit” dhe nr. 512, datë 25.09.2025 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”, Ministria ju pakësua programi “Zhvillimi i Turizmit” (04760). Me Aktin Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, buxhetit të Ministrisë ju pakësua fondi i mbetur për programin Zhvillimi i Turizmit (04760) në buxhetin e vitit 2025. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit riformatohet në Ministria e Mjedisit.

Në vijim të ndryshimit të fushës së përgjegjësisë sipas VKM nr. 185, datë 15.10.2025 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mjedisit” u miratua struktura e re e Aparatit të Ministrisë së Mjedisit me 106 punonjës. Njëkohësisht u pakësua numri i institucioneve të varësisë: Agjencia Kombëtare e Bregdetit bashkë me 4 Agjencitë Rajonale si edhe Agjencia Kombëtare e Turizmit” të cilat u bënë pjesë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Në zbatim të strukturave të miratuara numri i përgjithshëm i planifikuar i punonjësve u bë 741 dhe numri faktik 680.

EMP-të me në krye DEMP kanë realizuar monitorimin e performancës së programeve, konkretisht të politikës së programeve, objektivave, treguesve të performancës, si dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore në funksion të tyre për të gjithë artikujt përkatës.

Gjatë vitit 2025, Ministria e Mjedisit (MM), në kuadër të monitorimit të buxhetit ka përgatitur në fund të çdo muaji evidencën e shpenzimeve korrente dhe kapitale, të rakorduara me planin e buxhetit dhe realizimin faktik të thesarit sipas SIFQ.

Ky raport përmban një analizë të detajuar për periudhën janar-dhjetor 2025, lidhur me arritjen e treguesve dhe objektivave të parashikuara në programet buxhetore si më poshtë:

1. “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”
2. “Mbrojtja e Mjedisit”
3. “Administrimi i Pyjeve”
4. “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane”
5. “Zhvillimi i Turizmit” (Janar-Tetor 2025)

Me VKM-në nr. 774, datë 13.12.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 19, datë 03.02.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, ”, u krijua njësi e re shpenzuese në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës” me 19 punonjës në strukturë. Ministria dhe Zyra e Administrimit të Parkut në zbatim të vendimeve morën masat për çeljen e Niptit, domain, kodit të institucionit dhe buxhetit të shpenzimeve korente për funksionimin e ZAPK- Vjosë. Buxheti për shpenzimet korente u çel me miratimin e Ministrisë së Financave me shkresën nr. 9921/1, datë 02.07.2025, për transferimin e fondeve nga Aparati i Ministrisë programi i pyjeve për njësinë e re shpenzuese.

Bashkëlidhur këtij raporti gjenden anekset e plotësuara të specifikuara në Udhëzim. Të dhënat janë rakorduar me planin e buxhetit dhe realizimin faktik 12 mujor të thesarit sipas SIFQ-it për shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale në buxhetin e miratuar për vitin 2025.

Buxheti i vitit 2025 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është çelur sipas shkresave të poshtë cituara dhe për periudhën janar- dhjetor ka patur ndryshime në plan buxhetor si vijon:

- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 17548/55 prot., datë 13.01.2025 “Dërgohet detajimi i shpenzimeve korrente për vitet 2025-2027”, vlera në total për MM është 2.331.060.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 3123/1 prot., datë 12.03.2025 “Dërgohet detajimi i buxhetit 2025-2027 për shpenzimet kapitale”, vlera në total për MM është 1,643,847,000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 2505/1 prot., datë 12.02.2025 “Mbi miratimin e detajimit të planit për fondin e veçantë 2025”, sipas Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, vlera në total për MM është 1.900.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 9326/42, datë 04.07.2025 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 6, datë 11.06.2025 për shpenzimet korrente”, shtuar fonde në llogarinë 604 në vlerën 7,000,000 lekë, pakësuar llogaria 600 në vlerën 25,000,000 lekë dhe 601 në vlerën 2.000.000 lekë efekti total rezulton pakësim në vlerën 20,000,000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 9326/7, datë 23.06.2025 “Mbi detajimin e ndryshimeve të buxhetit sipas Aktit Normativ nr. 6, datë 11.06.2025 për shpenzimet kapitale”, shtuar fonde në shpenzimet kapitale në kapitullin 01, 02 dhe 03 në vlerën 522,173,431 lekë, pakësuar fonde në shpenzimet kapitale në kapitullin 01 dhe 02 në vlerën 523,083,431 lekë dhe efekti total rezulton pakësim në vlerën 910,000 lekë.
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM, Memo nr. 5634/1, datë 08.08.2025 “Mbi kërkesën e Bashkisë Gjirokastrë dhe Korçë, për mbështetje financiare në realizimin e aktiviteteve respektivisht “The Miss Globe 2025”, vlera 1,000,000 lekë dhe aktivitetit “Festa e Birrës 2025 ” vlera 1,000,000 lekë, pakësim në total 2,000,000 lekë në programin e turizmit.

- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 14935/1, datë 23.10.2025 “Mbi miratimin e shtesës së planit për fondin e veçantë 2025”, u shtua fond i veçantë për Agjencinë Kombëtare të Zonave të mbrojtura në vlerën 263,000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 14505/105, datë 06.11.2025 “Zbatimi i Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025 për shpenzimet kapitale”, pakësuar fondet aparatit e MM, si edhe në institucionet e varësinë në vlerë 90,385,000, ku peshën më të madhe e zë Mbështetja Financiare Projekti BERZH në vlerën 79,3885,000, si dhe shtuar fondet në vlerë 65,885,000 lekë, efekti total rezulton pakësim në vlerën 24,500,000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 14505/142, datë 18.11.2025 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025 për shpenzimet korente”, transferimi i programit “Zhvillimi i Turizmit” (04760) sipas fushës së përgjegjësisë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.09.2025 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”, si edhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 25.09.2025 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit”, solli si efekt pakësimin e të gjithë planit të papërdorur të programit të Turizmit në vlerën 70,164,997 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 14505/36, datë 14.11.2025 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025 për shpenzimet korrente”, pakësuar fondet e lira në llogaritë ekonomike 600, 601, 602 në vlerën 34,750,000 lekë të Aparatit dhe disa institucioneve të varësisë, shtuar fonde në llogarinë 601 në vlerën 100,000 lekë për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat/Elbasan/Korçë, efekti total rezulton pakësim në vlerën 34,650,000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 18095/50, datë 29.12.2025 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 11, datë 19.12.2025 për shpenzimet korrente”, pakësuar fondet e lira në llogaritë ekonomike 600, 601, 602 të aparatit dhe disa institucioneve të varësisë në vlerën 21,000,000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 18059/95, datë 31.12.2025 “Zbatimi i Aktit Normativ nr. 11, datë 19.12.2025 për shpenzimet kapitale”, pakësuar fondet në Aparatin e MM, si edhe në institucionet e varësinë në vlerë 747,158,100, si dhe shtuar fondet për shpenzime kapitale në kapitull 2, Financim i Huaj në vlerë 105,523,100 lekë, efekti total rezulton pakësim në vlerën 641,635,000 lekë.

3. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Realizimi i Buxhetit të MM sipas Programeve Buxhetore

Në 000 lekë

Buxheti MM	Plani Vjetor	Ndryshimet/ Alokimet	Plani Dhjetor 2025	Realizimi Dhjetor 2025	Realizimi në %
Planifikim, Menaxhim & Administrim	344,727	(12,486)	332,241	318,558	96%
Administrimi i Pyjeve	1,079,550	35,839	1,115,389	1,092,346	98%
Mbrojtja e Mjedisit	956,770	(245,885)	710,885	582,961	82%
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	585,860	(435,805)	150,055	147,161	98%
TOTALI	2,966,907	(658,337)	2,308,570	2,141,026	93%

Realizimi i Buxhetit të MM sipas Llogarive Ekonomike

Në 000 lekë

	Plani Vjetor	Ndryshimet/ Alokimet	Plani Dhjetor 2025	Realizimi, Dhjetor 2025	Realizimi në %
Llogaria 600-601	1,052,850	(64,850)	988,000	976,705	99%
Llogaria 602	333,538	(17,868)	315,670	278,896	88%
Llogaria 604	5,000	-	5,000	4,246	85%
Llogaria 605	20,000	-	20,000	12,275	61%
Llogaria 606	1,672	2,131	3,803	3,105	82%
Llogaria 230-231 (financim i brendshëm)	963,847	(204,750)	759,097	714,845	94%
Llogaria 230-231 (financim i huaj)	590,000	(373,000)	217,000	150,953	70%
TOTALI	2,966,907	(658,337)	2,308,570	2,141,026	93%

Realizimi i Buxhetit të MM sipas burimit të financimit

Në 000 lekë

	Plani Vjetor	Ndryshimet/ Alokimet	Plani Dhjetor 2025	Realizimi Dhjetor 2025	Realizimi në %
Buxheti i Shtetit Kapitull 1&3&4	2,376,907	(285,337)	2,091,570	1,990,072	95%
Financim i Huaj Kapitull 2	590,000	(373,000)	217,000	150,953	70%
Shpenzimet nga te ardhura jashte limiti Kapitull 6				97,308	
TOTALI	2,966,907	(658,337)	2,308,570	2,238,333	97%

- **Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (600-601)** për vitin 2025 janë realizuar në masën 99% kundrejt fondeve totale të planifikuara.
- **Shpenzimet korrente (602-606)** për vitin 2025 janë realizuar në masën 87% kundrejt fondeve totale të planifikuara.
- **Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm (230-231)** për vitin 2025 janë realizuar në masën 94 % kundrejt fondeve totale të planifikuara.
- **Shpenzimet kapitale me financim të huaj (230-231)** pëe vitin 2025 janë realizuar në masën 70% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit (Kap. 6) pëe vitin 2025 paraqiten në vlerën 97,307,868 lekë, ku përfshihen shpenzimet e realizuara kryesisht nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1156, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen nga zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre” si edhe grantet e UNEP të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetor” Ministria mbledh të ardhura për llogari të Thesarit të Shtetit për dhënien e lejeve mjedisore, liçencave, autorizimeve, tarifave vjetore, transit, eksport mbetje jo të rrezikshme, heqje fondi pyjor etj. Në ndryshim nga Aparati dhe institucionet e tjera të varësisë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), i përdor të ardhurat e gjeneruara nga tarifat e miratuara për zonat e mbrojtura.

Alokimet Janar- Dhjetor 2025

Lidhur me ndryshimet në buxhet gjatë periudhës raportuese janë realizuar transferime fondi, brenda tavaneve të miratuara të Ministrisë për shpenzime korrente dhe kapitale, si vijon:

- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 978/1, datë 30.01.2025 “Rialokim fondi për vitin 2025”, nga llogaria 602 në llogarinë 604 në vlerën 11,300,000 lekë për Agjencinë Kombëtare të Turizmit.
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM me Memon nr. 344/3, datë 07.02.2025 “Për zbatimin e Urdhrit nr. 20, datë 14.01.2025, të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit “Për miratimin e alokimit të fondit që përfitojnë mbështetje financiare në fushën e turizmit nga buxheti i shtetit”, në vlerën 2,000,000 lekë, në llogarinë 602, rialokuar nga produkti “Turizëm i promovuar” për Agjencinë Kombëtare të Turizmit.
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM me Memon nr. 1100, datë 10.02.2025 “Kërkesë për rialokim fondesh në zbatim të prezantimit të Shqipërisë si Vend Pritës i ITB Berlin 2025”, në vlerën totale 13,000,000 lekë, në llogarinë 602 dhe 604.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 5157/1, datë 25.03.2025 “Transferim fondi nga artikulli 602 në artikullin 606 për AKM, për kompensim funksionari përfitues të telefonisë celulare konform VKM-së nr. 673/2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, i ndryshuar.
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM me Memon nr. 2617 prot., datë 04.04.2025 “Mbi kërkesën për transferim fondi në programin buxhetor “Zhvillimi i Turizmit” në llogarinë ekonomike 602 midis produkteve “Monitorime të kryera përgjatë vijës bregdetare” dhe “Bashki të mbështetura për pastrimin e bregdetit” të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, në vlerën 3,446,319 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 6175, datë 09.04.2025 “Ç’ngurtësim fondi”, për shpenzimet kapitale në programin Menaxhimi i Mbetjeve Urbane, detajim i fondit në kapitullin 04 në vlerën 23,573,569 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 5776/1, datë 14.04.2025 “Transferim fondi për shpenzimet kapitale”, projekti “BE per Ekonomine Qarkulluese dhe Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri” në vlerën 30,000,000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 9921/1 prot., datë 02.07.2025 “Mbi miratimin e transferimit të fondit për vitet 2025-2027”, për Zyrën e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, vlera në total për MM është 26,000,000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 10484/1 prot., datë 14.07.2025 “Mbi miratimin e rialokimit të planit për fondin e veçantë për vitin 2025”, për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura , vlera në total për MM është 586.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 11299/1 prot., datë 01.08.2025 “Mbi transferimin e e fondit për shpenzime kapitale”, për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, vlera në total për MM është 705,000 lekë;
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM, Memo nr. 5926, datë 08.08.2025 “Mbi kërkesën për transferim fondi në llogarinë ekonomike Mallra dhe Shërbime (602) nga

Aparati i Ministrisë për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat/Korçë/Elbasan në programin e mjedisit.”, vlera 700,000 lekë.

- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM, Memo nr. 1182, datë 13.11.2025 “Mbi kërkesën për rialokim fondi në programin e mjedisit, në llogaritë ekonomike 600 dhe 601, nga Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër në programin e mjedisit.”, vlera 3,400,000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 16354/1 prot., datë 25.11.2025 “Mbi transferimin e fondit për shpenzime operative”, nga llogarie ekonomike 600 në 602 për Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, vlera 1,000,000 lekë.

- **Referuar numrit të punonjësve të Ministrisë**, konform strukturave të miratuara, për vitin 2025 janë planifikuar 838 punonjës. Në muajin qershor u krijua njësia e re shpenzuese në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës” me 19 punonjës në strukturë, dhe në total numri i planifikuar u bë 857 ndërsa numri faktik pëe vitin 2025 është 791 punonjës. Me ndryshimin e fushës së përgjegjësisë dhe miratimin e Ministrisë së Financave nr 17706/1, datë 19.12.2025 “Miratim i detajimit të numrit të punonjesve” në total numri i planifikuar i punonjësve është 741 ndërsa numri faktik për 12 mujorin e vitit 2025 është 680 punonjës. Diferenca midis numrit të planifikuar dhe atij faktik vjen si rezultat i vendeve vakante në strukturat e miratuara. Numri i punonjësve i detajuar paraqitet si më poshtë:

Numri i Punonjesve 12-2025

Line	Inst.		Plan	Fakti
26	1026061	Agjencia Rajonale e Mjedisit Berat /Elbasan/Korçe	39	36
26	1026069	Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokaster	37	37
26	1026098	Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjoses"	19	15
26	1026073	Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër/Lezhë/Kukës	33	26
26	1026001	Aparati i Ministrise se Mjedisit	106	96
26	1026060	Agjencia Kombëtare e Mjedisit (nivel qendror)	101	93
26	1026081	Agjencia Rajonale e Mjedisit Tirane/Durres/Diber	40	39
26	1026087	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	308	285
26	1026095	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	32	28
26	1026096	Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve	26	25

Struktura e Aparatit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 185, datë 15.10.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mjedisit”. Institucionet e varësisë: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe 4 Agjencitë Rajonale, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 194, datë 04.10.2024 “Për miratimin

e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 195, datë 04.10.2024 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 26, datë 03.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, të ndryshuar; Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe 4 Agjencitë Rajonale, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 217, datë 01.11.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”; Agjencia Kombëtare e Turizmit bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 116, datë 26.08.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Turizmit”; Agjencia Kombëtare e Pyjeve, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 191, datë 23.09.2024 “Për një ndryshim në Urdhrin nr.192 datë 18.11.2022. të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”; Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 94, datë 12.6.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”; Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës” bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 19 datë 03.02.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”.

Me ndryshimin e fushës së përgjegjësisë dhe VKM nr. 185, datë 15.10.2025 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mjedisit” u miratua struktura e re e Aparatit të Ministrisë së Mjedisit me 106 punonjës. Njëkohësisht u pakësua numri i institucioneve të varësisë: Agjencia Kombëtare e Bregdetit bashkë me 4 Agjencitë Rajonale si edhe Agjencia Kombëtare e Turizmit” të cilat u bënë pjesë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

4.PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI

Treguesit e performancës me bazë gjinore për vitin 2025 paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me Aktivitetet Turistike ku përfaqësuese ligjore janë gra:

Nr.	AKTIVITETI	TOTALI	GRA	GRA në %
1	Struktura akomoduese /Aplikime	1100	101	9%
2	Mbështetje për projekte për zhvillimin e turizmit të financuara	28	14	50%

5.PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVEL PROGRAMI

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Ky program ka si objektivi rritjen, forcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese për një planifikim, menaxhim dhe administrim të politikave dhe strategjive në fushën e mjedisit, pyjeve, turizmit si dhe koordinimi i punës me të gjitha drejtoritë e politikave për kontrollin

dhe zbatimin e tyre; trajnimi si një mjet strategjik për rritjen e burimeve njerëzore; hartimi dhe rritja e kontrollit mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve financiare në të gjithë strukturën e MM-së dhe institucionet e varësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat në kuadër të procesit të integritetit. Qëllimi i politikës së programit është përmirësimi i strukturës funksionale për një menaxhim sa më efektiv të burimeve njerëzore për të krijuar një staf permanent dhe sa më të qëndrueshëm për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e mjedisit.

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2025, për këtë program janë realizuar produktet dhe treguesit e performancës së synuar.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për periudhën janar-dhjetor 2025 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art.	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti Progresiv	Realizimi në %
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2025	Dhjetor 2025	
	Planifikim, Menaxhim & Administrim	344,727	(12,486)	332,241	318,558	96%
600	Pagat	201,749	(9,300)	192,449	191,865	100%
601	Sigurime Shoqërore	35,068	(4,000)	31,068	30,510	98%
602	Shpenz. Operative	83,310	-	83,310	81,889	98%
605	Transferta korrente të huaja	20,000	-	20,000	12,275	61%
606	Transferte tek individët	1,600	(186)	1,414	1,158	82%
M260001	Orendi Pajisje	-	1,000	1,000	861	86%
18AV402	Pajisje TIK	3,000	-	3,000	-	-

Në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” për periudhën janar-dhjetor 2025, shpenzimet korrente janë realizuar 98% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Produkti “*Akte ligjore dhe nënligjore*” është realizuar në masën 97% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Në shpenzimet kapitale të planifikuara (llogaria 231), projekti “*Pajisje TIK*” parashikuar në plan buxhetin e vitit 2025 nuk arriti të realizohej për arsye se, AKSHI në cilësinë e Organit Qëndror Blerës për këtë procedurë, nuk arriti ta përfundojë brenda vitit 2025 procedurën e prokurimit dhe kontraktimin e një operatori ekonomik të suksesshëm për shkak të ankesave pranë KPP, dhe si rrjedhojë AKSHI nuk dërgoi një Autorizim për nënshkrim kontrate.

Produkti Orendi Pajisje është realizuar në masën 86% për vitin 2025, kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Programi “Mbrojtja e Mjedisit”

Programi i Mbrojtjes së Mjedisit mbulon sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, nëpërmjet garantimit të përputhshmërisë së veprimtarive me ndikim në mjedis me kushtet e lejeve mjedisore dhe kërkesave të legjislacionit mjedisor, përmirësimin të cilësisë së ajrit në zonat kryesore urbane; menaxhimit të integruar të mbetjeve, parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes dhe rreziqeve nga aksidentet industriale, përsheptimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjes së gazrave me efekt serë; ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, biodiversitetit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura.

Monitorimi i këtij programi kryhet për të vlerësuar përmbushjen e objektivave nëpërmjet produkteve dhe indikatorëve të përcaktuar për secilin prej tyre. Analiza vlerësuese tregon se përgjithësisht ato janë në përputhje me afatet dhe standartet e parashikuara në PBA 2025-2027.

Puna për realizimin e programit “Mbrojtja e Mjedisit” është përqëndruar në tre shtylla kryesore, që lidhen respektivisht me objektivat e përcaktuar në dokumentin e PBA-së:

1. Hartimi i legjislacionit për transpozimin e aquis së mjedisit dhe aquis të ndryshimeve klimatike;
2. Zbatimi i legjislacionit që lidhet me:
 - a) Monitorimin e mjedisit nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për fushën e cilësisë së ajrit, zhurmave, cilësisë së ujërave, mbetjeve, biodiversitetit;
 - b) Shqyrtimin dhe miratimin e Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në mjedis dhe lejeve mjedisore;
3. Inspektime kontrolli për aktivitetet industriale dhe veprimtari prodhuese, lidhur me shkarkimet në ajër, menaxhimin e mbetjeve industriale, urbane si dhe zhurmave.

Objektivi i parë lidhet me sigurimin e mbrojtjes së mjedisit në një nivel të lartë, janë hartuar akte ligjore dhe nënligjore që transpozojnë direktiva, rregullore dhe vendime të BE për fushën e mjedisit dhe të ndryshimeve klimatike.

Objektivi i dytë lidhet me përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare ndaj mjedisit dhe klimës. Janë hartuar raporte kombëtare për zbatimin e detyrimeve kombëtare sipas kërkesave nga Sekretariatet e Konventave për konventat që mbulojnë nga Drejtoria e Mjedisit, Ndryshimeve Klimatike dhe Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura; në kuadër të integritit evropian janë përgatitur raportimet në kuadër të takimeve të nënkomiteteve BE-Shqipëri për mjedisin dhe Komitetin e Stabilizim Asociimit.

Objektivi i tretë lidhet me kryerjen e raporteve të monitorimit të cilësisë së ajrit, zhurmave e ujërave urbane, të cilësisë së ujërave në lumenj, liqene, dete dhe laguna, të monitorimit të treguesve në pyje dhe biodiversitet dhe të treguesve të shkarkimit e transferimit të ndotësve dhe raporti vjetor i gjendjes në mjedis. Janë shqyrtuar dosjet e aplikimit për vlerësimin e

ndikimit në mjedis. Janë shqyrtuar dosjet e lejeve të mjedisit të tipit A dhe B. Është bërë raportimi dhe publikimi i aktiviteteve të AKM-së në vijimësi.

Mbrojtja e mjedisit është programi buxhetor i ndarë në tre produkte:

- Raporte monitorimi- nga 4200 raporte të planifikuara në vit, janë realizuar 3840 raporte për periudhën 12 mujore. Parashikimi për këtë produkt për 12 mujorin është realizuar 91%.
- Dosje të shqyrtuara për përfitimin e lejeve të mjedisit- për vitin 2025 janë parashikuar për shqyrtim 576 dosje në vit dhe janë shqyrtuar 794 aplikime për leje Mjedisit të tipit A, B, për 12 mujorin. Numri i dosjeve është në varësi të aplikimeve që bëjnë subjektet e interesuara. Nga analiza rezulton janë shqyrtuar 130 % e aplikimeve.
- Inspektime të kryera- Për këtë produkt janë parashikuar që do të realizohen 1150 për vitin 2025 dhe rezulton që gjatë 12-mujorit janë realizuar 644 inspektime ose 56%.

Transparencë në procesin e Lejeve Mjedisore

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit e ka bërë pjesë funksionale të punës së saj konsultimin me publikun;
- Kriteret për aplikim janë të gjitha online dhe të aksesueshme për aplikuesit;
- Subjektet kontrollojnë nëpërmjet QKL të gjitha procedurat, të cilat janë online;
- Çdo leje mjedisore publikohet online dhe publikohen për 20 ditë të gjitha projektet e detajuara me vendndodhjen, qëllimin e detajet teknike përkatëse.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për periudhën janar - dhjetor 2025 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti Progresiv	Realizimi në %
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2025	Dhjetor 2025	
	Mbrojtja e Mjedisit	566,770	(71,885)	494,885	432,008	87%
600	Pagat	301,200	(22,100)	279,100	275,503	99%
601	Sigurime Shoqërore	50,070	(3,350)	46,720	45,776	98%
602	Shpenzime Operative	120,500	(12,040)	108,460	87,969	81%
604	Të tjera Transferta Brendshme	5,000		5,000	4,246	85%

606	Transferim tek individët	-	385	385	302	78%
18AV402	Pajisje TIK AKM	2,000	-	2,000	-	-
18BH301	TVSH Raporte performace te hartuara	3,000	-	3,000	224	7%
18BH101	TVSH Sistem i ngritur per parandalimin e mbetjeve detare	6,125	(5,680)	445	442	99%
18BG704	Kosto Lokale Ekonomia qarkulluese IPA 3	54,045	(30,000)	24,045	-	-
M260248	TVSH Projekti i zonës biosferike të parkut kombëtar të Prespës	8,030	(3,000)	5,030	2,126	42%
18BH302	TVSH - Projekti "Ndarja ne burim e mbetjeve shtepiake ne Bashkine Berat"	7,000	(3,000)	4,000	3,129	78%
18BG708	TVSH Mbeshtetje per programin e mjedisit	3,500	(2,800)	700	-	%
18CH902	Kosto Lokale SA Creativity	800	(800)	-	-	%
18CH902	TVSH SA Creativity	4,000	(1,500)	2,500	2,378	95%
18BG709	Kosto Lokale Same Sea	1,000	(1,000)	-	-	%
18BG707	TVSH BE per Ekonomine Qarkulluese dhe Ekonomia qarkulluese per zhvillimin e qendrueshem urban ne Shqiperi (GIZ)	500	13,000	13,500	9,914	73 %

Në programin “Mbrojtja e Mjedisit” për periudhën janar-dhjetor 2025 shpenzimet korrente (600-606) janë realizuar në nivelin 94% kundrejt fondeve totale vjetore të planifikuara. Shpenzimet kapitale (230-231) me financim të brendshëm janë realizuar në nivelin 33% kundrejt fondeve totale vjetore të planifikuara.

Produkti “*Akte ligjore dhe nënligjore, dokumenta strategjike*” është realizuar në masën 87% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, kundrejt fondeve vjetore të planifikuara;

Produkti “*Inspektime te kryera*” është realizuar në masën 96% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, kundrejt fondeve vjetore të planifikuara;

Produkti “*Raporte monitorimi*” është realizuar në masën 94% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, kundrejt fondeve vjetore të planifikuara;

Produkti “*Dosje të shqyrtuara*” është realizuar në masën 86% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

- ❖ Projektet në programin e mjedisit janë të renditura si më poshtë:
 - Projekti “*Pajisje TIK*” është një procedurë që zhvillohet nga AKSHI. Në shpenzimet kapitale të planifikuara (llogaria 231), projekti “*Pajisje TIK*” parashikuar në plan buxhetin e vitit 2025 nuk arriti të realizohej për arsye se, AKSHI në cilësinë e Organit Qëndror Blerës për këtë procedurë, nuk arriti t’a përfundojë brenda vitit 2025 procedurën e prokurimit dhe kontraktimin e një operatori ekonomik të suksesshëm për shkak të ankesave pranë KPP, dhe si rrjedhojë AKSHI nuk dërgoi një Autorizim për nënshkrim kontrate.
 - Projekti “*Raporte performance të hartuara*” është realizuar në masën 7% kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2025, sipas faturave që ka paraqitur.
 - TVSH “*Sistem i ngritur per parandalimin e mbetjeve detare*” është realizuar në masën 99% kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2025.
 - Kosto Lokale *Ekonomia qarkulluese IPA 3*: Kosto lokale e planifikuar nuk është realizuar për vitin 2025, pasi nuk pati kërkesë nga njësia e menaxhimit të projektit.
 - TVSH “*Projekti i zonës biosferike të parkut kombëtar të Prespës*” është realizuar në masën 42% kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2025.
 - TVSH - Projekti “*Ndarja ne burim e mbetjeve shtepiake ne Bashkine Berat*” është realizuar në masën 78% kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2025.
 - TVSH “*Mbështetje per programin e mjedisit*” Projekti eshte në zbatim, por nuk ka paraqitur kerkesa per rimbursimin e TVSH-së.
 - *SA Creativity TVSH* është realizuar në masën 95% kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2025.
 - *TVSH BE per Ekonomine Qarkulluese dhe Ekonomia qarkulluese per zhvillimin e qendrueshem urban ne Shqiperi (GIZ)* është realizuar në masën 73% kundrejt fondeve të planifikuara për vitin 2025.

2. Programi “Administrimi i Pyjeve”

Programi i Administrimit të Pyjeve përfshin hartimin e politikave për menaxhimin e qëndrueshëm të ekosistemeve, duke promovuar zhvillimin e një ekonomie të gjelbër, koordinimin në nivel qendror, rajonal dhe lokal të praktikave më të mira në drejtim të menaxhimit të burimeve natyrore duke rritur eficiencën në përdorimin e tyre, përdorimin e metodave dhe mjeteve miqësore me mjedisin në planet operationale të zbatimit. Automatizimi i bazës së të dhënave për regjistrin pyjor dhe digjitalizimi i hartave, mbështetjen e kërkimit, zhvillimit teknologjik e inovacioneve në pyje, dhënia e shërbimit këshillimor dhe aftësimin e kapaciteteve të personelit pyjor dhe administrativ lokal, harmonizimi ligjor e nënligjor,

bashkëpunimi institucional me struktura të tjera të interesuara për menaxhimin e qëndrueshëm e ruajtjen e biodiversitetit.

Monitorimi i këtij programi kryhet për të vlerësuar përmbushjen e objektivave nëpërmjet produkteve dhe indikatorëve të përcaktuar për secilin prej tyre. Analiza vlerësuese tregon se përgjithësisht ato janë në përputhje me afatet dhe standartet e parashikuara në PBA 2025-2027.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për periudhën janar- dhjetor 2025 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti progresiv	Realizimi në%
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2025	Dhjetor 2025	
	Administrimi i Pyjeve	1,079,550	34,839	1,114,389	1,092,346	98%
600	Pagat	358,350	(18,300)	340,050	336,755	99%
601	Sigurime Shoqërore	60,300	(2,600)	57,700	56,557	98%
602	Shpenzime Operative	119,728	(8,028)	111,700	97,874	88%
606	Transferim tek individët	72	1,882	1,954	1,645	84%
18BE611	Zbatim Projekti "Ngritja e Infrastruktures Turistike me theks tek ajo Ujore Eko-Park Ulza"	200,100	61,885	261,985	261,882	100%
18BE615	Zbatim Projekti "Qendra Multifunkionale ne Luginen e Vjoses"	341,000	-	341,000	337,633	99%

Në programin “Administrimi i Pyjeve” shpenzimet korrente (600-606) janë realizuar në nivelin 96% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2025.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm (230-231) janë realizuar në nivelin 99% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2025.

Produkti “Raporte monitorimi në Zonat e Mbrojtura” është realizuar në masën 99% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Produkti “Objekte të administruara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura” është realizuar në masën 88% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Produkti “Inventarizim dhe kadastër e kryer” është realizuar në masën 98% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Produkti “*Plane menaxhimi për pyjet*” është realizuar në masën 92% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Produkti “Parku Vjose i miremenaxhuar” është realizuar në masën 75% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

Në zbatim të Vendimit nr. 774, datë 13.12.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, gjatë vitit 2025 u krijua Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës” në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Produkti “Parku Vjosë i mirëmenaxhuar” është detajuar në fillim të vitit në Aparatin e Ministrisë në programin “Adiminstrimi i Pyjeve”.

❖ Projektet e programit Administrimi i Pyjeve paraqiten si më poshtë:

- “*Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore - Eco Park Ulza*” është realizuar në në masën 100 % kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2025. “Projekti i Zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe Zona përreth tij”, po zhvillohet në zbatim të kontratës nr. 3008/8 Prot., datë 08.07.2024, REF-04366-05-10-2024, në vlerën 377,094,055.80 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë million e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë)lekë pa TVSH dhe 452,512,866.96 (katërqind e pesëdhjetë e dy milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH, me afat realizimi 21 (njëzetë e një) muaj nga data e njoftimit të fillimit të punimeve, me fond të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, për 3 (tre) vite 2024, 2025 dhe 2026. Nëpërmjet këtij projekti synohet të realizohet ruajtja në gjendjen natyrore të peizazhit, sistemet ekologjike dhe karakteristikat natyrore të zonës. Ky projekt synon zhvillimin e qëndrueshëm të territorit ku bënë pjesë zona, të kontrollit të zhvillimit, rritjes së mirëqënies së popullsisë vendase, punësimit, jetësës më të mirë dhe mbrojtjes së aseteve natyrore e mjedisit. Qëllimi kryesor i projektit është mbrojtja e vlerave biologjike, kulturore, sociale, ekonomike, të peizazhit të zonës. Realizimi i këtij projekti synon të përmirësojë akoma më tepër pjesën atraktive të Parkut Natyror të Liqenit të Ulzës dhe zonave përreth tij dhe do të ndikojë ndjeshëm në zhvillimin e turizmit të kësaj zone.Për vitin 2025 punimet për këtë projekt kanë patur një ecuri me ritme mjaft të kënaqshme, dhe si rrjedhojë përveç buxhetit të miratuar, u alokua dhe një fond shtesë prej 61,885,000 lekë me Aktin Normativ Nr.10, datë 08.10.2025, vlerë e cila për vitin 2025 u realizua në masën 100 %.
- Zbatim Projekti “*Qendra multifunktionale në Luginën e Vjosës*” është realizuar në masën 99% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2025, për Stacionet e Informimit Përmet dhe Vlorë dhe për Qendrën Tepelenë po zhvillohet në zbatim të Kontratës së Punës me nr. 6271/8 Prot., datë 02.12.2024, REF-23839-10-10-2024, në vlerën 546,097,766.65 (pesëqind e dyzetë e gjashtë milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë

e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH dhe 655,317,319.98 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë me TVSH, me afat realizimi 27 (njëzetë e shtatë) muaj nga data e njoftimit të fillimit të punimeve, me fond të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, për 3 (tre) vite 2025, 2026 dhe 2027. Projekti ka filluar zbatimin në datë 13.12.2024 - Përfundimi sipas kontratës do të jetë në datë 13.03.2027. Ky projekt synon të krijojë një model për turizmin ekologjik dhe edukimin mjedisor në Shqipëri, duke celebruar lumin Vjosa si lumin e fundit të egër në Europë. Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi i qëndrueshëm i territorit ku shtrihet Zona e Mbrojtur “Lumi i Vjosës”, e cila është shpallur “Park Kombëtar”, Kategoria II nëpërmjet VKM nr. 155, datë 13.03.2023 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të Lumit Vjosa “Park Kombëtar”, Kategoria II”. Lumi Vjosa si “Park Kombëtar” ka lehtësuar zgjidhjet e sfidave me të cilat përballlet ekosistemi, si ndotja e ujit, tokës, menaxhimi i mbetjeve dhe shpyllëzimi. Gjithashtu, janë krijuar mundësi ekonomike për komunitetet lokale, nëpërmjet turizmit të qëndrueshëm dhe ka ndihmuar në adresimin e problemeve që lidhen me migrimin e brendshëm. Marrja e statusit të Kategorisë II të IUCN-së, Park Kombëtar nënkupton që Vjosës do t’i ofrohet mbrojtje, sipas standardeve më të larta ndërkombehtarë, duke siguruar integritetin e saj ekologjik. Punimet për këtë projekt kanë patur një ecuri me ritme të kënaqshme, dhe si rrjedhojë për vitin 2025 investimi u realizua në masën 99 %.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura: Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka realizuar trugesit e performancës si më poshtë vijon:

Objektivi: Përmirësimi i menaxhimit efektiv dhe sigurimi i vazhdueshëm i mbrojtjes dhe administrimit të zonave të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë:

1. Numri i turistëve të hyrë në zonat e mbrojtura (ZM) është 4,079,023 turistë, në Parkun Kombëtar Dajt, Parkun Natyror Syri i Kaltër, Kune-Vain-Patok-Fushekuqe-Ishem; Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, për periudhën janar- dhjetor 2025.
2. Numri i monitorimeve të kryera për vlerësimin e biodiversitetit dhe vlerave natyrore në ZM është 26,333 monitorime;
3. Numri i orëve mësimore të realizuara për ndërgjegjësim dhe informim në ZM është 381 orë mësimore;
4. Numri i takimeve dhe festave të organizuara me aktorët lokal në ZM është 371 takime.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve: Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka realizuar objektivat e politikës si më poshtë vijon:

1. Monitorimi i rrjetit të burimeve gjenetike pyjore në popullatat e pishës së mesdhetare në Bashkitë, ku janë të ngritura rrjeti i monitorimit të këtyre llojeve;
2. Monitorimi i gjendjes shëndetësore dhe vitalitetit në pyje në 61 Bashkitë e vendit;
3. Monitorimi i gjendjes së ekzemplarëve të llojeve të drurëve pyjorë dhe BMET të kërcënuar. Matja e treguesëve, kontrolli i numrit të ekzemplarëve, përkrahimi i gjendjes vegetative, gjendjes fitosanitare dhe plotësimi i formularëve përkatës;
4. Trajnime të stafëve të 61 Bashkive në shkallë vendi;

5. Botimi i dokumentacioneve teknike dhe raporti i gjendjes së pyjeve;
6. Vlerësimi i performancës në sektorin e pyjeve, vlerësimin e gjendjes së pyjeve, impaktit të sektorit përmes ndjekjes së zbatimit të politikave (DPP), strategjive dhe programeve kombëtare dhe trajnimet me stafet e personelit të pyjeve pranë NJ.V.V.

politikës*:	reguesit te Performances/Produktit	Performances /Produktit	planifikuar ne vitin korent Dit Pune	rishtuar ne vitin korent	per periudhen raportuese	reguesit te Performances/Produktit
I. Objektiv 1	Pergatitja e raportit mbi gjendjen e pyjeve sipas tregueseve te monitorimit 1. Komponenti, monitorimi i rrjetit te burimeve gjenetike pyjore ne popullatat e pishes se mesdhetare ne Bashkite, ku jane te ngritura rrjeti i monitorimit te ketyre llojeve.	1. Vezhgimi i gjendjes se burimeve gjenetike pyjore (RNI) ne popullatat e pishes mesdhetare 2. Plotesimi i skedinave pershkruese per cdo grumbull pyjor. 3. Kryerja e matjeve te druveve dhe hedhja e te dhenave ne skedat perkatese sipas metodologjise se percaktuar.	225	225	225	100%
		Plotesimi, perpunimi dhe regjistrimi i bazes te dhenave dhe hartografise sipas RNI per cdo bashki.	10	10	10	100%
		Trajnimi i specialisteve te menaxhimit prane Njesive te Vetqeverisjes Vendore mbi metodologjine e matjes se tregueseve sasiore.	30	30	30	100%
		Percaktimi i Shtirirjes se habitateve; Rekomandime per konservimin e rrjetit te RNI -ve ne popullatat e pishws medhetare	20	20	20	100%
		Shuma I	285	285	285	100%
II.Objektiv 2	Pergatitja e raportit pjesor mbi gjendjen e shendetesore te fondit pyjor sipas tregueseve te monitorimit, komponenti; 1. Monitorimi i gjendies shendetesore dhe vitalitetit ne pyje. ne shkallë Kombëtare (duke perfshirë 61 NJVV).	Monitorim i gjendjes shendetesore te pyjore ne siperfaqet prove sipas llojeve. Vezhgimi i rrjetit, matja dhe grumbullimi i te dhenave pershkruese me personat e kontaktit.Kryerja e matjeve sipas metodes se punes dhe plotesimi i formulareve te terrenit.	360	360	360	100%
		Trajnimi ispecialisteve te menaxhimit te Njesive te Vetqeverisjes Vendore mbi treguesit e matshem gjate procesit te monitorimit.	10	10	10	100%
		Hedhja e te dhenave ne skedat perkatese .Regjistrimi dhe perpunimi i te dhenave per cdo bashki ne bazen e te dhenave dhe përlllogaritja e treguesve përkatës	20	20	20	100%
		Shuma II	390	390	390	100%
III. Objektiv 3	Pergatitja e raportit mbi gjendjen e disa specieve drunore te kercenuara sipas tregueseve te monitorimit Komponenti: I.	Verifikimi i gjendjes dhe ecurise se llojeve brenda rrjetit të sipërfaqeve të monitorimit të ngritur gjatë viteve të mëparshme. Monitorim i gjendjes se eksemplarëve të llojeve druveve pyjore të kërcënuar. Matja e treguesve dentrometrik dhe kontrolli i numrit të	60	60	60	100%

	Monitorimi I disa specieve te kercenuara dhe ne rezik zhdukje zonat e perhapjes sipas bashkive ku eshte ngritur rrjeti i SP	egzemplarëve, përshkrimi i gjendjes vegetative, gjendja fitosanitare. Plotësimi i formularëve përkatës.				
		Trajnimi i specialisteve te menaxhimit te Njesive te Qeverisjes Vendore mbi treguesit e matshem gjate procesit te monitorimit.	10	10	10	100%
		Hedhja e te dhenave ne skedat perkatese .Rregjistrimi dhe perpunimi i te dhenave per cdo lloj dhe vendmatje ne bazen e te dhenave dhe perlllogaritja e treguesve perkatës	20	20	20	100%
		Përgatitja e treguesit te perhapjes së llojeve te kercenuara dhe ne rrezik zhdukje.	20	20	20	100%
		Shuma III	110	110	110	100%
IV.Objektivi 4	Aktivite te ndryshme në pyjeve.	Zhvillimi i aktiviteteve që do të zhvillohen nga NjVV, AKZM, shoqatat e ndryshme dhe donatorët për pyjet/kullotat dhe BMET.	30	30	30	100%
		Shuma IV	30	30	30	100%
V. Objektivi 5	Supervizimi i kontratave te lidhura rishtaz me institucionet qe kryejne monitorimin e tregusve te pyjeve sipas parashikimeve ne Planin Kombetar te Monitorimeve per pyjet ne viti 2025	Ndjekja e procesit te monitorimit ne zbatim te kontatave perkatese, metodologjive dhe kalendarit te monitorimit. Hartimi i dokumentave per vleresimin e procesit dhe Draft-raportit gjashtemujor dhe vjetor	10	10	10	100%
		Shuma V	10	10	10	100%

Objekti vi I	Rritja e aftësive menaxhuese të strukturave pyjore në bashki për hartimin e planit operacional vjetor dhe zbatimin e programit të planifikimit për mbjelle drurësh pyjore dhe pyllëzime për periudhën 2024;	Trajnimi i specialisteve te menaxhimit prane Njesive te Vetqeverisjes Vendore mbi hartimin e planeve operationale dhe projekteve te mbjelljeve dhe pyllëzimeve (nr. takimesh)	10	10	10	100%
		Ndjekja në vijimësi e punës për zbatimin e planit operacional vjetor dhe projekteve te pyllëzimit në 61 bashki, per vitin 2024	22	22	21	95%
		Shuma I	32	32	31	97%

Objekti vi 2	Koordinimi dhe sensibilizimi i aktorëve dhe donatorëve për "Vitin Shqiptar të Pyjeve 2024"	Identifikimi i aktorë dhe donatorë. Lidhja e marveshjeve të bashkëpunimit	1	1	1	100 %
		Ndërtimi i partneriteteve dhe bashkëpunimit më të fortë përmes angazhimeve të përbashkëta në kuadër shpalljes së vitit 2024 si "Viti Shqiptar i Pyjeve" në aktivitetet promovuese ndërgjegjësuese etj. që ndërmeren në këtë kuadër	2	2	1	50%
		Shuma II	3	3	2	67%
Objekti vi 3	Ndërgjegjësimi dhe promovimi i vlerave të pasurisë pyjore Masivizimi i muajve të pyllëzimit .	Promovimi i vlerave dhe rëndësisë të pyjeve nëpërmjet orëve mësimore, dhe veprimtarive që do të organizohen	20	20	19	95%
		"Informimi mbi gjendjen e pyjeve në vendin tone, edukimi përmes temave që trajtohen në orët mësimore dhe mjeteve divulgative (fletëpalosje, postera, etj).	10	10	10	100 %
		Aktivitete të gjelbërimit të ambjenteve të shkollave, kurorave të qytetit, etj, kombinuar me ore edukimi mjedisor me fokus rolin e pyjeve në cilësinë e jetës në tokë, cilësinë e ujit, ajrit, dhe cilësinë ushqimore.	10	10	10	100 %
I Objekti vi 1	Faza përgatitore (puna në zyrë) për fillimin e Inventarit Kombëtar të pyjeve dhe Kullotave	1. Evidentimi i treguesve që do të grumbullohen nga IKPK-ja për tufat e sipërfaqeve provë të qarkut Fier. 2. Hedhja e koordinatave gjeografike të tufave të sipërfaqeve provë në GPS. 3 Sigurimi i paisjeve të nevojshme për të realizuar punimet e terrenit.	80	80	80	100
II Objekti vi 2	Përshtatja e sistemit të Open Foris Collect për regjistrimin e të dhënave që do të grumbullohen në terren dhe për regjistrimin e matjeve që do të kryhen, kjo sipas Manualit për grumbullimin e të dhënave të terrenit të IKPK-së.	Përditësimi dhe përshtatja e skedarëve e të dhënave që do të grumbullohen gjatë matjeve në terren. Krijimi i skedarëve në programin Open Foris	60	60	0	0
		- Krijimi i skedarëve në program Open Foris				
III Objekti vi 3	Fazë përgatitore në terren. Ushtrim për vajtjen në terren dhe grumbullimin e të dhënave të terrenit në një grup sipërfaqesh provë të IKPK-së	Rifreskim i mënyrës së vajtjes në grup sipërfaqet provë dhe gjetjes së qendrës së sipërfaqeve provë (kunjtë metalik) - Zhvillimi i modelit dhe metodave të grumbullimit të të dhënave sipas manualit të kryerjes së punimeve të terrenit. -Kryerja e matjeve në sipërfaqet provë dhe regjistrimi i të dhënave në formularët e terrenit.	60	60	60	100
IV Objekti vi 4	Proçesi realizimit të matjeve në terren nga grupi i punës	Plani i punës për zbatimin e zhvillimit të procesit në terren për grumbullimin e të dhënave. Regjistrimi i të dhënave të grumbulluara në formularët e terrenit	10 4	68	63	93
V Objekti vi 5	Përpunimi I të dhënave të grumbulluara nga matjet e kryera në terren	Hedhja në databazë në kompjuter I të dhënave të grumbulluara dhe matjet e kryera dhe regjistruara në formul;arët e terrenit. -Përpunimi I të dhënave të grumbulluara. -Përgatitja e raportit për punën e bërë për IKPK	18 0	18 0	18 0	100

Zyra e Administrimit te Parkut Kombëtar "Lumi i Vjoses: Për periudhën Korrik -Dhjetor 2025 ka realizuar objektivat e politikës si më poshtë vijon:

Objektivi kryesor është mirëmenaxhimi i Parkut Kombëtar Lumi i Vjosës, të sigurojë ruajtjen dhe mbrojtjen e territorit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjoses", në zbatim të legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura, nëpërmjet administrimit efektiv të Parkut Kombëtar dhe koordinimit të punës me institucionet përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor për zbatimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar. Mbrojtja e biodiversitetit natyror, së bashku me strukturën bazë ekologjike dhe proceset mjedisore mbështetëse në përputhje me standardet e Kategorisë II të IUCN, si dhe promovimi i aktiviteteve rekreative dhe edukative në përputhje me konceptin e turizmit të qëndrueshëm dhe nxitja e zhvillimit të komuniteteve lokale.

Gjatë kësaj periudhe nga krijimi i zyrës së Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës", janë hedhur hapat e para si fillim, për plotësimin e zyrës me stafin e miratuar sipas organikës, organizimin e brendshëm, takime me ADZM-të dhe marrja në dorëzim të dosjeve për pjesën që i takon ZAPK "LUMI VJOSE".

Janë kryer inspektime në terren për evidentimin e problematikave, gjithashtu janë zhvilluar aksione pastrami nga ana e stafit në zona të cilat përbëjnë rrezik të konsiderueshëm për biodiversitetin.

Zyra ka kryer takime të ndryshme gjatë kësaj periudhe me shkolla të ndryshme të rajonit, me banorët e zonave dhe me palët e tjera që përfshihen në Luginën e Vjosës.

- Numri i monitorimeve të kryera për vlerësimin e biodiversitetit dhe vlerave natyrore në PKLV është 48, janë realizuar 8 monitorime për biodiversitetin në muaj.
- Numri i orëve mesimore që realizohen për ndërgjegjesim dhe infomim për PKLV. është 48, janë zhvilluar orë mësimore në 2 shkolla në muaj, për 6 muaj, me nga 4 orë për secilin aktivitet.
- Numri i organizimeve, takimeve dhe festave me aktorë lokal në PKLV është 60.

3. Programi "Zhvillimi i Turizmit" Periudha Janar-Tetor 2025 (kalon te MTKS)

Me Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 25.09.2025 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit" dhe nr. 512, datë 25.09.2025 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit", ministrisë ju pakësua programi "Zhvillimi i Turizmit" (04760). Me Aktin Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, buxhetit të ministrisë ju pakësua fondi për programin Zhvillimi i Turizmit (04760) në buxhetin e vitit 2025.

Në vijim të ndryshimit të fushës së përgjegjësisë sipas vkm nr 185, date 15.10.2025 "Për miratimin e strukture dhe organikës së Ministrisë së Mjedisit" u miratua struktura e re e aparatit të Ministrisë së Mjedisit me 106 punonjës. Njëkohësisht u pakësua numri i institucioneve të varësisë: Agjencia Kombëtare e Bregdetit bashkë me 4 Agjencitë Rajonale si

edhe Agjencia Kombëtare e Turizmit” të cilat u bënë pjesë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Sa më sipër relacioni për programin e turizmit është kryer për periudhën Janar-Tetor 2025, ndërkohë që plan buxheti për programin “Zhvillimi i Turizmit” nuk është paraqitur në Aneksat përkatëse në zbatim të Udhëzimit të Nr.127, Datë 19.12.2025 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025”, pika 11 e kreut IV.

Programi i Zhvillimit të Turizmit mbështetet në strategjinë sektoriale të turizmit, planin e saj të veprimit, si dhe të masave në strategjitë ndërsektoriale. Programi i Zhvillimit të Turizmit synon një turizëm të qëndrueshëm në kohë, social, mjedisor dhe ekonomik që arrihet nëpërmjet:

1) Përmirësimit dhe rishikimit në vazhdimësi të kuadrit ligjor për turizmin me fokus harmonizimin e tij me politikat e qeverisë; 2) Përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet incentivave ligjore, fuqizimit të bashkëpunimit publik-privat; 3) Sistemit të licencimit, klasifikimit dhe çertifikimit të sipërmarrjeve turistike me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtjen e konsumatorit, si dhe monitorimit të sipërmarrjeve turistike; 4) Diversifikimit të produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor etj. Objektivi për “Diversifikimin e ofertës turistike duke synuar praninë e turistëve gjatë gjithë vitit” rezulton përgjithësisht i realizuar. Me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor, që lidhet direkt ose indirekt me zhvillimin e sektorit të turizmit, gjatë vitit 2025 janë hartuar akte ligjore e nënligjore, janë kryer inspektime të vijës bregdetare për evidentimin e zhvillimeve më të fundit duke nisur nga çështjet e ndërtimeve të reja, ndotjet mjedisore, përdorimin e hapësirave publike, kriteret për stacion plazhi. Për mbarëvajtjen e sezonit veror është intensifikuar puna për monitorimin në terren. Është siguruar pjesëmarrja në panairë ndërkombëtare, si dhe janë organizuar aktivitete të tjera promovuese.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për periudhën janar-tetor 2025 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti Progresiv	Realizimi në %
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2025	Dhjetor 2025	
	Zhvillimi i Turizmit	1,008,000	(152,360)	855,640	855,640	100%
600	Pagat	140,400	10,862	129,538	129,538	100%
601	Sigurime Shoqerore	23,400	(2,728)	20,672	20,672	100%
602	Shpenzime Operative	403,920	(62,580)	341,340	341,340	100%

604	Te tjera transferta te brendshme	350,280	13,026	363,306	363,306	100%
606	Transferim tek individet	0	80	80	80	100%
18BE902	Mbeshtetje Financiare Projekti BERZH	80,090	(80,090)	0	0	-
24AG501	Krijimi I Web-it te ri te Agjencise Kombetare te Turizmit	5,910	(5,910)	0	0	-
18AV402	Blerje Pajisje TIK AKT	2,000	(2,000)	0	0	-
18AV402	Blerje Pajisje TIK AKB	2,000	(2,000)		0	-
18BE912	B-Visa 2030	-	705	705	705	100%

Në programin “Zhvillimi i Turizmit” shpenzimet korrente (600-606) janë realizuar në nivelin 100 % kundrejt fondeve vjetore të planifikuara deri Tetor 2025.

Produkti “Turizëm i promovuar” është realizuar në masën 100 % gjatë periudhës janar-tetor 2025, kundrejt fondeve të planifikuara.

Produkti “Panairi i Turizmit IT Berlin” është realizuar në masën 100% gjatë periudhës janar-tetor 2025, ndaj fondeve totale të planifikuara për vitin 2025. Pas suksesit të prezantimit të Shqipërisë në panairin e ITB për vitet 2023 dhe 2024, si dhe në vijim të interesit të shfaqur nga përfaqësuesit e ITB Berlin, Shqipëria është ftuar të jetë vendi mikpritës si “Host Country” në edicionin e 58-të, në ITB Berlin 2025.

Si Vendi i Nderit i ITB Berlin 2025, Shqipëria prezantoi trashëgiminë e saj të pasur natyrore e kulturore në tre ditët e këtij panairi global të turizmit si dhe në ceremoninë e hapjes më 3 Mars.

Nën sloganin “Albania All Senses”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë prezantoi buqetën e ofertave turistike të vendit nga data 4 deri më 6 mars 2025. Shqipëria ftoi të gjithë pjesëmarrësit e këtij panairi t’i bashkohen një udhëtimi gjithëpërfshirës përmes larmisë së ofertave, një programi të zgjeruar eventesh, performancash dhe aktiviteteve.

Produkti “Bashki të mbështetura për pastrimin e bregdetit” është realizuar në vlerë totale 202,692,555 lekë për ofrimin e shërbimit të pastrimit gjatë sezonit turistik, në 9 bashki bregdetare (Shkodër, Durrës, Kavajë, Rogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë) është realizuar në masën 100% gjatë periudhës.

Lidhur me produktin “Projekte për zhvillimin e turizmit të financuara” është realizuar në 138,733,760 lekë për vitin 2025. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit shpall thirrjen për përfitimin e mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit për vitin buxhetor 2025, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, privatë ose publikë, të cilët kanë në objekt të veprimtarisë së tyre turizmin, në funksion të mbështetjes së tematikës “Promovimin

e destinacioneve dhe zhvillimi i produkteve turistike në mbështetje të ofertës turistike për vitin 2025”

Thirrja synon zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëvjeter, si dhe promovimin e Shqipërisë si destinacion turistik tërheqës për vizitorët vendas dhe të huaj, promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike për zhvillimin e turizmit malor, natyror, kulturor, tradicional, kulinar, ekoturizmit, turizmit nostalgjik, turizmit të aventurës etj., gjithashtu edhe në mbështetje të veprimtarive të sezonit turistik për vitin 2025.

Thirrja qëndroi e hapur nga data 11 Dhjetor 2024 deri më datë 06 Janar 2025. Projektet duhet të realizohen brenda vitit buxhetor.

Atraksionet Turistike prezantohen dhe lidhen me një sërë tiparesh dalluese materiale, intelektuale dhe emocionale të një shoqërie që përfshin trashëgiminë historike dhe zonat kulturore, gastronominë, letërsinë, industrinë krijuese dhe kulturat e gjalla me stilin e tyre të jetesës, sistemet e vlerave, besimet dhe traditat.

Promovimi i destinacioneve turistike, edukimit dhe vlerave të veçanta lokale nëpërmjet zhvillimit të eventeve tradicionale dhe inovative të aktivitetit shpirtëror njerëzor, nxit dhe motivon pjesëmarrjen aktive të turistëve në përvojat shqiptare, atraksionet dhe potencialet e prekshme dhe të paprekshme të destinacioneve turistike.

Në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së projekteve që iu përgjigjën Thirrjes së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për mbështetje financiare të projekteve në turizëm, për vitin 2025, bazuar në vlerësimin e detajuar mbi dokumentacionin e dorëzuar, kohëzgjatjen e projektit, fondit për financimin e kërkuar, veprimtarinë e deritanishme të tyre, kontributit në fushën ku operojnë, përputhshmërinë e objektivave me politikat dhe strategjinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit etj., me propozim të Kolegjiumit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm, projektet e miratuara janë 28 (njëzet e tetë) nga 64 (gjashtëdhjetë e katër) aplikime të paraqitura:

Projektet e miratuara paraqiten sipas listës së mëposhtme:

	Emërtimi Projektit	Subjekti Përfitues
1	“Promovimi i turizmit në Vjosë”	Vjosa Explorer
2	“Turizmi juglindor”	“FLOEMI”
3	“Melodi për Turizmin”	Qendra Youth Rise
4	“Adriafest -Panairi i Turizmit”	Instituti për Shkencë dhe Kërkim në Arsimin e Lartë
5	“Check in Festival Tiranë”	PIK
6	“Tell me an Albanian story/ Tregomë një histori shqiptare”	Qendra “Dritare”
7	“Turizmi n’Tur”	Fondacioni “Startup Albania”
8	“Rindërtimi i etnografisë”	Lizeta Hatika
9	“Vala Fest 2025”	Bea Marketing & Promotions
10	“Himara International Music Festival (Edicioni IV)”	Vibrant Project Association

11	“Korabi-Thesar i turizmit Alpin”	Qendra Kombëtare e Lëvizjes Ambientaliste
12	“Albania Xperience”	Qendra “FuturAL”
13	“Wines of Albania-VINI THEATER Një simfoni e Verës,Kulturës dhe Gastronomisë Shqiptare”	MediaMix
14	“Peisazhe Turistike”	Qendra “Mirazh”
15	“Cloud Fest”	Shoqata “KREO”
16	“Locked in Paradise Festival”	Kevin Spahiu
17	“Ekoturizmi dhe Shishtaveci”	Instituti për Projekte, Programe dhe Politika IP3
18	“South Outdoor Festival”2025	“Qendra e Artit Kontemporan”
19	“Diell dhe dashuri -Dita e verës 2025”	Sindi Laloshi
20	“RiProTra”	Julian Elezi
21	“Destinacionet e pa zbuluara të Shqipërisë”	Fondacioni “Dritan Hoxha”
22	“Shkodra Aktive “Një rrugëtim i turizmit rekreativ”	Qendra “Culture is Us”
23	“The City Echoes/ Jehona e qytetit”	Jonid Koritari
24	“Check in Festival Gjirokastër”	PIK Green
25	“Festivali Gjiroclassica”	Shoqata “Promotor”
26	“Shanisha në kala”	Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim
27	“Life in the Castles – jeta në kala -udhëzues për fëmijë”	Shoqata Me WE
28	“Rocks Festival 5”	Albert Haloçi

Sa më sipër, 14 janë subjekte që administrohen nga gra dhe 14 janë subjekte që administrohen nga burra.

❖ Projektet e investimeve në programin e turizmit janë të renditura si më poshtë:

- Projekti “*Mbështetje Financiare Projekti BERZH*”: është kërkuar në MF pakësim fondi me anë të Aktit Normativ. Bazuar në Ligjin nr.39/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes “Për ndryshimin dhe rivendosjen e marrëveshjes nr. 1, në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 11 janar 2016 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit dhe sektorit të turizmit, BERZH-Shqipëri.
- Projekti “B-Visa 2030” është çelur me anë të Aktit Normativ nr. 6, datë 11.06.2025 dhe është realizuar në masën 100% kundrejt planit buxhetor.

4. Programi “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane”

Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve

Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve u krijua me anë të Vendimit nr. 132, datë 6.3.2024 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve” dhe me Urdhër nr. 94, datë 12.6.2024 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve” me 26 punonjës në strukturë.

Agjencia ka si mision të sigurojë:

- a) koordinimin, monitorimin dhe bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore (NJQV), institucionet e administratës publike dhe partnerët ndërkombëtarë në menaxhimin e integruar të mbetjeve, me qëllim kalimin e këtij sektori në ekonomi qarkulluese;
- b) promovimin dhe nxitjen e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve për zhvillimin gradual të grumbullimit përmes ndarjes në burim e riciklimit në shkallë të gjerë dhe monitorimin e implementimit të standardeve dhe edukimin mjedisor, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë vendim dhe dispozitat në ligjin përkatës për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Përgjegjësitë funksionale të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve

Agjencia ka këto përgjegjësi funksionale:

- a) të koordinojë punën me institucionet e administratës publike, në nivel qendror e vendor, partnerët ndërkombëtarë, investitorët dhe palët e interesuara për zbatimin e standardeve në menaxhimin efikas të integruar të mbetjeve, planifikimin territorial në infrastrukturën e mbetjeve dhe implementimin e tyre;
- b) të organizojë punën për edukimin mjedisor, promovimin dhe nxitjen e zbatimit të hierarkisë së mbetjeve për zhvillimin gradual të grumbullimit përmes ndarjes në burim e riciklimit në shkallë të gjerë.

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për periudhën janar- dhjetor 2025 paraqitet si më poshtë:

Në 000 lekë

Art	Emërtimi	Plani	Ndryshimet	Plani me ndryshime	Fakti progresiv	Realizimi në%
		Vjetor	Alokimet	Dhjetor 2025	Dhjetor 2025	

	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	385,860	(235,805)	150,055	147,161	98%
600	Pagat	39,000	(4,200)	34,800	34,1000	98%
601	Sigurime Shoqërore	7,113	(1,000)	6,113	5,640	92%
602	Shpenzime Operative	10,000	2,200	12,200	11,165	92%
606	Transferim tek individet	0	50	50	0	-
M260069	Orendi dhe pajisje	2,000	(1,080)	920	911	98 %
18AV402	Pajisje TIK	3,000	(3,000)	0	0	-
18BE201	Ndertim i venddepozitimit te Bushatit vazhdim faza II	0	53,401	53,401	53,401	100%
M063995	Ndertim i venddepozitimit te Bushatit vazhdim faza II	0	3,870	3,870	3,870	100%
M260149	Fond i ngrire (Projekte te programit)	324,747	(324,747)	0	0	-
18BE315	TVSH Mbeshtetje per zbatimin e MasterPlanit te Menaxhimit te Ngurta 2	-	18,343	18,343	18,343	100%
M063998	TVSH per sistemin e menaxhimit te mbetjeve te ngurta ne Qarkun e Vlores	-	20,357	20,357	19,730	97%

Në programin “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane” shpenzimet korrente (600-606) janë realizuar në nivelin 96% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2025.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm (230-231) janë realizuar në nivelin 99% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2025.

Produkti “*Raporte monitorimi per menaxhimin e integruar te mbetjeve*” është realizuar në masën 96% gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.

- *Orendi dhe pajisje* janë realizuar në nivelin 98% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara për vitin 2025.
- *Pajisje TIK* është një procedurë që zhvillohet nga AKSHI në cilësinë e Organit Qëndror Blerës për këtë procedurë, nuk arriti ta përfundojë brenda vitit 2025 procedurën e prokurimit dhe kontraktimin e një operatori ekonomik të suksesshëm për shkak të ankesave pranë KPP, dhe si rrjedhojë AKSHI nuk dërgoi një Autorizim për nënshkrim kontrate.
- *TVSH Mbeshtetje per zbatimin e Master Planit te Menaxhimit te Ngurta 2*, çelur me anë të shkresës së miratimit të Ministrisë së Financave nr. 6175, date 09.04.2025 është realizuar në masën 100% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara.
- *TVSH per sistemin e menaxhimit te mbetjeve te ngurta ne Qarkun e Vlores*, çelur me anë të shkresës së miratimit të Ministrisë së Financave nr. 6175, date 09.04.2025, realizuar në masën 97% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara. Programi synon krijimin e një sistemi të integruar, të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet

evropiane për menaxhimin e mbetjeve urbane në rajonin e Vlorës, duke përfshirë Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Selenicë.

Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve: Për periudhën ka realizuar treguesit e performancës si më poshtë vijon:

1. Raport Pjesor i monitorimit të bashkive për gjenerimin e mbetjeve. Mbledhja e të dhënave për informacionet e kerkuara nga bashkive në lidhje me menaxhimin e mbetjeve nga 61 Bashki
2. Realizimi i Aktivitetet ndërgjegjësuere gjatë periudhës janar-prill AKEM 90 postime. Fushata Ndergjegjesuese në rrjete sociale, postim, vidjo, info, email. Fushate informuese mbi edukimin mjedisor ,riciklimin dhe ndarjen e diferencuar të mbetjeve Përqindja e postimeve që kanë arritur një impakt me të lartë mjedisor nisur nga shikueshmeria dhe impakti i perlqyeshmerise dhe përhapja e informacionit për rëndësinë e riciklimit dhe përdorimit të materialeve ekologjike 85 postime.
3. Projekt edukimi mjedisor në terren në disa qendra të edukimit pas procesit mësimor. Fushate informuese mbi edukimin mjedisor ku përfshihet riciklimi dhe ndarja e diferencuar e mbetjeve. Fushate informuese mbi edukimin mjedisor riciklimin dhe ndarjen e diferencuar të mbetjeve në 12 qendra.
Nr nxenesve të informuar mbi edukimin mjedisor është 80 nxënës.
4. Raporte Monitorimi për menaxhimin e integruar të mbetjeve 28 raporte.

1. PROJEKTET KAPITALE

a) *Zbatimi i buxhetit për Projektet Kapitale me financim të brendshëm të MM-së për periudhën janar-dhjetor 2025:*

Nr.	Prog	Kap	Kodi projektit	Emri i projektit	Buxheti fillestar i celur	Alokime	Buxheti Perfundimtar	Realizimi progresiv	%
	01110	01	M260001	Orendi Pajisje	-	1,000,000	1,000,000	861,000	86%
	01110	01	18AV402	Pajisje TIK	3,000,000	-	3,000,000	-	-
				TOTALI PMA	3,000,000	1,000,000	4,000,000	861,120	22%
	04260	01	18BE611	Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore - Eco Park Ulza	200,100,000	61,885,000	261,985,000	261,882,417	100%
	04260	01	18BE615	Zbatim Projekti “Qendra multifunkionale në Luginen e Vjoses”	341,000,000	-	341,000,000	337,632,824	99%
				TOTALI PYJE	541,100,000	61,885,000	602,985,000	599,515,241	99%

05320	03	18BG704	Ekonomia qarkulluese IPA 3	54,045,000	(30,000,000)	24,045,000	0	0%
05320	03	18BG709	SameSea	1,000,000	(1,000,000)	0	0	-
05320	03	18CH902	SA Creativity	800,000	(800,000)	0	0	-
05320	04	18BG707	Be per Ekonomine Qarkulluese dhe Ekonomia qarkulluese per zhvillimin e qendrueshem urban ne Shqiperi (GIZ)	500,000	13,000,000	13,500,000	9,913,955	93%
05320	04	18BG708	Mbeshtetje per programin e mjedisit	3,500,000	(2,800,000)	700,000	0	0%
05320	04	18BH101	Sistem i ngritur per parandalimin e mbetjeve detare	6,125,000	(5,680,000)	445,000	441,898	99%
05320	04	18BH301	Raporte performance te hartuara	3,000,000	-	3,000,000	224,287	7%
05320	04	18BH302	TVSH - Projekti "Ndarja ne burim e mbetjeve shtepiake ne Bashkine Berat"	7,000,000	(3,000,000)	4,000,000	3,128,798	78%
05320	04	18CH902	SA Creativity	4,000,000	(1,500,000)	2,500,000	2,377,937	95%
05320	04	M260248	TVSH Projekti i zonës biosferike të parkut kombëtar të Prespës	8,030,000	(3,000,000)	5,030,000	2,125,954	42%
05320	01	18AV402	Pajisje TIK	2,000,000	-	2,000,000	-	0%
			TOTALI MJEDIS	90,000,000	(34,780,000)	55,220,000	18,212,829	33%
06220	01	M260069	Orendi dhe pajisje	2,000,000	(1,080,000)	920,000	910,800	99%
06220	01	18AV402	Pajisje TIK	3,000,000	(3,000,000)	0	-	-
06220	01	M260149	Fond i ngrire (Projekte te programit)	324,747,000	(324,747,000)	0	-	-
06220	04	18BE315	TVSH Mbeshtetje per zbatimin e MasterPlanit te Menaxhimit te Ngurta 2	-	18,342,940	18,342,940	18,342,939	100%
06220	04	M063998	TVSH per sistemin e menaxhimit te mbetjeve te ngurta ne Qarkun e Vlores	-	20,357,323	20,357,323	19,730,485	97%
06220	01	18BE201	Ndertim i venddepozitimit te Bushatit vazhdim faza II	-	53,401,184	53,401,184	53,401,184	100%
06220	01	M063995	Ndertim i venddepozitimit te Bushatit vazhdim faza II	-	3,870,553	3,870,553	3,870,553	100%

				TOTALI MBETJE	329,747,000	(232,855,000)	96,892,000	96,255,961	99%
				TOTALI MM	963,847,000	(204,750,000)	759,097,000	714,845,151	94%

b) Zbatimi i buxhetit për Projektet Kapitale me financim të huaj të MM-së për periudhën janar-dhjetor 2025:

Nr	Programi	Kodi i projektit	Emri i projektit	Buxheti fillestar i celur	Alokime	Buxheti Perfundimtar	Realizimi progresiv	%
			TOTALI MM	590,000,000	(373,000,000)	217,000,000	150,952,694	70%
	05320		Mbrojtja e Mjedisit	390,000,000	(174,000,000)	216,000,000	150,952,694	70%
	5320	18BG401	Platforma elektronike per menaxhimin e qendrueshem te burimeve ujore ne zonen nderkufitare Greqi-Shqiperi.	-	3,300	3,300	3,600	109%
	5320	18BG704	Ekonomia qarkulluese IPA 3	60,000,000	(51,000,000)	9,000,000	7,948,400	88%
	5320	18BG706	BE per natyren (UNDP)	30,000,000	(20,000,000)	10,000,000	25,716,740	257%
	5320	18BG707	BE per Ekonomine Qarkulluese dhe Ekonomia qarkulluese per zhvillimin e qendrueshem urban ne Shqiperi (GIZ)	50,000,000	(30,000,000)	20,000,000	-	0%
	5320	18BG708	Mbeshtetje per programin e mjedisit (SIDA)	30,000,000	(30,000,000)	-	-	-
	5320	18BG709	SameSea	8,000,000	(4,000,000)	4,000,000	233,794	6%
	5320	18BH001	Masa pilote te zbatuara	-	3,300	3,300	3,300	100%
	5320	18BH002	MPA Engage (IPA-Interreg Med)	-	3,300	3,300	3,600	109%
	5320	18BH005	WBC-RRI-NET (Horizont 2020)	-	3,300	3,300	3,600	109%
	5320	18BH006	Clean and Resilient Enviorenment for	132,000,000	(100,000,000)	32,000,000	8,382,900	26%

			Blue Sea Project CARE4BLUESEA					
5320	18BH101	Sistem i ngritur per parandalimin e mbetjeve detare	30,000,000	(20,000,000)	10,000,000	-	0%	
5320	18BH202	Menaxhimi i kimikateve dhe mbetjeve farmaceutike ne Shqiperi (Str.Sound.Chem)	-	35,000,000	35,000,000	11,319,290	32%	
5320	18BH301	Raporte performance te hartuara	30,000,000	(28,000,000)	2,000,000	2,933,030	147%	
5320	18CH501	TUNE - UP	-	3,300	3,300	3,600	109%	
5320	18CH601	Projekti Sigurimi i Sherbimeve per menaxhimin e burimeve natyrore-RE-SOURCE	-	3,300	3,300	3,600	109%	
5320	18CH901	ALL TOUR- Paketa turistike te zhvilluara per turizmin kulturor dhe natyror	-	3,300	3,300	3,600	109%	
5320	18CH902	Sa Creativity	20,000,000	-	20,000,000	18,679,890	93%	
5320	GM26033	Rezervati nderkufitar i Prespes	-	30,000,000	30,000,000	23,733,720	79%	
5320	GM26074	SANEX Kapitulli 27-SIDA	-	40,000,000	40,000,000	51,980,030	0%	
5320	18BG803	Programi per nje zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike ne Shqiperi GIZ	-	2,976,900	2,976,900	-	0%	
5320	18CH903	MIRAMAR	-	500,000	500,000	-	0%	
5320	25AB701	Raportimi i peste kombetar UNFCC UNEP	-	-	-	-		
04260		Administrimi Pyjeve		1,000,000	1,000,000	-	0%	
04260	25AD101	Resilient Trees		500,000	500,000		0%	
04260	25AD102	Firesmarter		500,000	500,000		0%	
06220		Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	200,000,000	(200,000,000)		-	-	
06220	M260149		200,000,000	(200,000,000)	0	-	-	

Në tabelën e mësipërme të zbatimit të buxhetit për projektet me financim të huaj përfshihen ato projekte për të cilat është çelur plan buxhetor fillestar. Kemi një realizim total të kapitullit

2 në masën 70% kundrejt fondeve të planifikuara. Ky nivel i realizimit vjen për shkak se disa nga projektet janë në fazë fillestare dhe nuk kanë patur shpenzime financiare gjatë periudhës raportuese.

Financim i Huaj sipas sistemit SIFQ rezulton me realizim në vlerën 150,952,694 lekë. Një pjesë e projekteve kanë si shpenzim komisionet bankare.

Projektet janë grante, ndërsa Clean and Resilient Environment for Blue Sea Project CARE4BLUESEA financohet me kredi.

Clean and Resilient Environment for Blue Sea Project CARE4BLUESEA financohet nga Banka Botërore. Projekti zbatohet nga Ministria e Mjedisit, përmes Ekipit të Menaxhimit të Projektit (PMT), dhe nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), përmes Njësisë të Koordinimit të Projektit (PCU), në koordinim me njësitë e qeverisjes vendore dhe përfituesit në zonat përfituese.

Gjatë periudhës Prill – Dhjetor 2025, projekti ka qenë në fazën fillestare të implementimit, me fokus të veçantë në ngritjen e strukturave institucionale, vendosjen e sistemeve financiare, përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe nisjen e proceseve të prokurimit.

Përsa I përket Ministrisë të Mjedisit, menjëherë pas hyrjes në fuqi të projektit, u ngrit Project Management Team brenda Ministrisë së Mjedisit dhe u operacionalizua Project Coordination Unit në AKUK. U hapën llogaritë e dedikuara në Bankën e Shqipërisë dhe u vendosën procedurat e menaxhimit financiar dhe prokurimit në përputhje me kërkesat e Bankës Botërore. U studiuan dokumentet bazë të kuadrit mjedisor dhe social, përfshirë Environmental and Social Management Framework, Stakeholder Engagement Plan dhe instrumente të tjera përkatëse.

Në aspektin teknik, gjatë vitit 2025 për komponentin 1, janë përgatitur Termat e referencës dhe janë shpallur thirrjet për asistencë teknike në fushën e monitorimit të mbetjeve, përmirësimit të performancës operacionale dhe financiare të shërbimeve të mbetjeve, si dhe organizimin e fushatave ndërgjegjësuese për nxitjen e ndryshimit të sjelljes në lidhje me përdorimin e ambienteve sanitare, rëndësia e menaxhimit të mbetjeve dhe janë hartuar Termat për aktivitete të tjera si për verifikimin e performancës së bashkive në kuadër të EPBI. Është organizuar workshop kombëtar për prezantimin e manualit të EPBI, me pjesëmarrjen e bashkive të zonës Gjirokastrë – Vlorë Jug, duke shënuar nisjen formale të skemës së investimeve të bazuara në performancë.

Në Komponentin 2.3, janë hartuar dhe janë në proces rishikimi TOR për asistencë teknike në planifikimin e ndërhyrjeve për pyllëzim dhe kontroll të erozionit në pellgun e Vjosës.

2. NDRYSHIMET NË BUXHET

Lidhur me ndryshimet në buxhet gjatë periudhës raportuese janë realizuar transferime fondi, brenda tavaneve të miratuara të ministrisë për shpenzime korrente dhe kapitale, si vijon:

- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 978/1, datë 30.01.2025 “Rialokim fondi për vitin 2025”, nga llogaria 602 në llogarinë 604 në vlerën 11,300,000 lekë për Agjencinë Kombëtare të Turizmit.
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM me Memon nr. 344/3, datë 07.02.2025 “Për zbatimin e Urdhrit nr. 20, datë 14.01.2025, të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit “Për miratimin e alokimit të fondit që përfitojnë mbështetje financiare në fushën e turizmit nga buxheti i shtetit”, në vlerën 2,000,000 lekë, në llogarinë 602, rialokuar nga produkti “Turizëm i promovuar” për Agjencinë Kombëtare të Turizmit.
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM me Memon nr. 1100, datë 10.02.2025 “Kërkesë për rialokim fondesh në zbatim të prezantimit të Shqipërisë si Vend Pritës i ITB Berlin 2025”, në vlerën totale 13,000,000 lekë, në llogarinë 602 dhe 604.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 5157/1, datë 25.03.2025 “Transferim fondi nga artikulli 602 në artikullin 606 për AKM, për kompensim funksionari përfitues të telefonisë celulare konform VKM-së nr. 673/2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, i ndryshuar.
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM me Memon nr. 2617 prot., datë 04.04.2025 “Mbi kërkesën për transferim fondi në programin buxhetor “Zhvillimi i Turizmit” në llogarinë ekonomike 602 midis produkteve “Monitorime të kryera përgjatë vijës bregdetare” dhe “Bashki të mbështetura për pastrimin e bregdetit” të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, në vlerën 3,446,319 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 6175, datë 09.04.2025 “Ç’ngurtësim fondi”, për shpenzimet kapitale në programin Menaxhimi i Mbetjeve Urbane, detajim i fondit në kapitullin 04 në vlerën 23,573,569 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financave nr. 5776/1, datë 14.04.2025 “Transferim fondi për shpenzimet kapitale”, projekti “BE per Ekonomine Qarkulluese dhe Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri” në vlerën 30,000,000 lekë.
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 9921/1 prot., datë 02.07.2025 “Mbi miratimin e transferimit të fondit për vitet 2025-2027”, për Zyrën e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, vlera në total për MM është 26,000,000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 10484/1 prot., datë 14.07.2025 “Mbi miratimin e rialokimit të planit për fondin e veçantë për vitin 2025”, për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura , vlera në total për MM është 586.000 lekë;
- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 11299/1 prot., datë 01.08.2025 “Mbi transferimin e e fondit për shpenzime kapitale”, për Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, vlera në total për MM është 705,000 lekë;
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM, Memo nr. 5926, datë 08.08.2025 “Mbi kërkesën për transferim fondi në llogarinë ekonomike Mallra dhe Shërbime (602) nga aparati i Ministrisë për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat/Korçë/Elbasan në programin e mjedisit”, vlera 700,000 lekë.
- Miratim i Sekretarit të Përgjithshëm MM, Memo nr. 1182, datë 13.11.2025 “Mbi kërkesën për rialokim fondi në programin e mjedisit, në llogaritë ekonomike 600 dhe

601, nga Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër në programin e mjedisit.”, vlera 3,400,000 lekë.

- Miratim i Ministrisë së Financës nr. 16354/1 prot., datë 25.11.2025 “Mbi transferimin e fondit për shpenzime operative”, nga llogarie ekonomike 600 në 602 për Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, vlera 1,000,000 lekë.

Transferimet janë realizuar brenda tavanëve të miratuara të ministrisë për shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale. Ndryshimet që kanë impakt në tavanet buxhetore të vitit 2025, janë listuar në fillim të këtij raportimi.

Buxheti total fillestar i miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është në vlerën **3,974,907,000** lekë, efekti total i alokimeve gjatë vitit 2025 është në vlerën (810,696,997) lekë dhe buxheti përfundimtar i miratuar është në vlerën **3,164,210,003** lekë. Realizimi i buxhetit është në vlerën **2,996,665,587** lekë, në masën 95%.

3. PËRFUNDIME

Për sa më sipër, për ta konkluduar, realizimi i buxhetit të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2025 paraqitet si vijon:

- Buxheti i planifikuar në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” është realizuar në masën 96% ndaj fondeve vjetore të planifikuara;
- Buxheti i planifikuar në programin “Administrimi i Pyjeve” është realizuar në masën 98% ndaj fondeve vjetore të planifikuara;
- Buxheti i planifikuar në programin “Mbrojtja e Mjedisit” është realizuar në masën 82% ndaj fondeve vjetore të planifikuara;
- Buxheti i planifikuar në programin “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane” është realizuar në masën 98% ndaj fondeve vjetore të planifikuara.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në masën 94% ndaj fondeve vjetore të planifikuara.

Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në masën 70% ndaj fondeve vjetore të planifikuara.